



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivery	15.03.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRASHK	1148/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.41/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: , Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.41/2021 të datës 01.02.2021, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.41/2021 e datës 01.02.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, më datë 04.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 394/2021 e regjistruar me numër A.nr.41/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës materiale për periudhën Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, sipas pakos emergjente COVID-19.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.02.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit të Policia e Kosovës. Këshilli me datë 04.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll 394/2021 te regjistruar me numër A.nr.41/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 15.01.2021 nga

dhe Lista e zyrtarëve të angazhuar në punë; Vendimin e datës 12.02.2019 për sistemim për kohë të pacaktuar të ankuesit; E-mailin e datës 18.02.2021, 09.02.2021 nga Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 20.08.2014; Përshkrimi i detyrave të punës Radiokomunikues; E-mailin e datës 21.12.2020, 09.10.2020 nga E-mailin e datës 12.11.2020 nga Kartela e nëpunësit për vitin 2020 dhe 2021; E-mailin e datës 10.02.2021 nga Vendimin me Nr.02/32 të datës 25.09.2020 dhe Vendimin Nr.06/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe Përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoje se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 20.08.2014 të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Zyrtar i bazës së të Dhënave" mirëpo në bazë të Vendimit të datës 12.02.2019 ankuesi është sistemuar për kohë të pacaktuar nga pozita "Zyrtar i bazës së të Dhënave" në pozitën "Radiokomunikues", i cili vendim është ende në fuqi, kështu që ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar nga cilësia e pozitës "Radiokomunikues".

Lidhur me pranueshmerinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë;* 6. *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji ka konstatuar se pozita "radio komunikues" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht ankuesi në bazë të kësaj pozite nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.41/2021 e datës 01.02.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i



nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtaret publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.41/2021

Avdyll BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

